

Universiteti i Prishtinës

“Hasan Prishtina”

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 [URL: http://www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

Fax: +381-38-512223 [Mail: mjekesia@uni-pr.edu](mailto:mjekesia@uni-pr.edu)

1. Ref. nr. 6935 Prishtinë, 12.09.2024

Raport i Komisionit për shqyrtimin e ankesave të parashtruara për raportet e Komisioneve Recensuese të publikuara në buletinet për procedurat e përzgjedhjes lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime për vitin akademik 2024/25, në konkursin e shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me nr.2/3426, të datës 25.07.2024

Në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë me numër 6615 të datës 28.08.2024 është emëruar Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruara lidhur me raportet e Komisioneve Recensuese për procedurat e përzgjedhjes lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime për vitin akademik 2024/25, në përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Astrit Hamza - Kryetar
2. Prof. Ass. Dr. Aida Loshaj – Anëtare
3. Ass. Dr. Nora Aliu –Anëtare

Me datën 12.09.2024 në ora 09:00 komisioni për shqyrtimin e ankesave ka filluar shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve të cilët kanë parashtruar ankesa, duke u bazuar ne Statutin e UP-se, Rregulloren me nr. 2/254 te UP-se të datës 17.07.2024 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës.

Pas vlerësimit të numrit të ankesave të deponuara (15), komisioni për shqyrtimin e ankesave konstaton se 15 kandidatë kanë parashtruar ankesën e tyre, dhe të njejtë janë paraqitur me radhitje si në vijim:

1. Auror Rrahmani- pozita 2/3
2. Arbnor Cakiqi-pozita 3
3. Besnik Dakaj-pozita 5
4. Rinor Bejiqi- pozita 22
5. Saranda Hyseni Musliu- pozita 25
6. Arben Vishaj-pozita 25
7. Dukagjin Zeqiraj-pozita 25
8. Bleron Faiku- pozita 30
9. Ulpiana Ahmeti-pozita 30
10. Suela Hoxha-pozita 28/30/31
11. Miradije Imeri-pozita 35/36/37/38
12. Marigonë Shabani-pozita 38
13. Abdullah Gruda-pozita 36/37
14. Zana Shabani-Isenaj- pozita 40/41/42/44
15. Flora Qafleshi-pozita 43

1. Auror Rrahmani- pozita 2/3, ka parashtruar ankesë:

1.1 Kandidati ankesen e bazon në faktin se komisioni vlerësues duke propozuar Dr. Andi Elshani dhe Dr. Bardha Dervishaj, ka shkelur rregulloren Nr.2/254 dt 17.7.24, dhe nenin 153 pika 3 dhe 4 të statutit të UP-së Nr. 013-92 datë 19.07.2024, i miratur me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni i ankesave pas analizimit të dosjeve të kandidatëve të apostrofuuar më lartë si të propozuar dhe pretendimeve të ankuesit konstaton se ankesa për kandidatin Dr. Andi Elshani është e bazuar, ndërkaq pretendimet për kandidatën tjetër Dr. Bardha Dervishaj i gjen të pabazuara.

Nga sa u tha me lart, **komisioni për ankesa konstaton se ankesa e kandidatit në piken e parë është e bazuar, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lënda të kthehet në Komisionin recensues për rishqyrtim.**

2. Arbnor Cakiqi-pozita 3, ka parashtruan ankesë:

2.1 Kandidati ankesen e bazon në faktin se komisioni vlerësues duke propozuar Dr. Andi Elshani, ka shkelur rregulloren Nr.2/254 dt 17.7.24, dhe nenin 153 pika 3 dhe 4 të statutit të UP-së Nr. 013-92 datë 19.07.2024, i miratur me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni i ankesave pas analizimit të dosjeve të kandidatëve të apostrofuuar më lartë si të propozuar dhe pretendimeve të ankuesit konstaton se ankesa për kandidatin Dr. Andi Elshani është e bazuar, ndërkaq pretendimet për kandidatën tjetër Dr. Bardha Dervishaj i gjen të pabazuara.

Nga sa u tha me lart, **komisioni për ankesa konstaton se ankesa e kandidatit në piken e parë është e bazuar, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lënda të kthehet në Komisionin recensues për rishqyrtim.**

3. Besnik Dakaj-pozita 5, ka parashtruar ankesë:

3.1 Kandidati pretendon se për poziten për të cilën ka aplikuar është propozuar kandidatja Mirlinda Dehari-Zeka e lindur më 29.05.1974 që është në kundërshtim me statutin e UP-së dhe rregulloren në fuqi. Po ashtu kandidati ofron dëshmi për kandidaten në fjalë se si është refuzuar në FSHMN-UP konkretisht për shkak të moshës.

Komisioni për ankesa pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatës së apostrofuar, e gjen të bazuar ankesën e ankuesit dhe propozon që lënda të kthehet në komision recensues.

4. Rinor Bejiqi- pozita 12, ka parashtruar ankesë:

4.1 Kandidati ka ushtruar ankesë për mosshqyrtim të dokumentacionit aplikues pasi nuk i figuron emri as tek kandidatet e zgjedhur as tek kandidatet e refuzuar. Ai pretendon se është gabim teknik në aplikim me email të ndryshëm dhe se ka dëshmi për aplikacion.

Komisioni për ankesa konstaton se në sistemin e aplikimit të të gjithë kandidatëve në këtë pozitë, aplikimi i ankuesit nuk figuron.

5. Saranda Hyseni-Musliu- pozita 25, ka parashtruar ankesë:

5.1 Kandidatja pretendon se komisioni vlerësues nuk ka bërë vlerësimin e duhur duke përdorur standarte të dyfishta duke pranuar kandidatë që kanë notën mesatare më të ulët se sa kriteret e vendosura në konkurs.

5.2 Po ashtu ankuesja pretendon se komisioni nuk i ka njohur pozitën e punës si Specialiste e Sëmundjeve Infektive pranë Klinikës Infektive të QKUK-së për të cilën ankuesja ka aplikuar në konkursin publik të datë 11.06.2024 për pozitën nr. 1 Specialist i sëmundjeve ngjitëse, në klinikën e Sëmundjeve Infektive, pa kunderkandidat, pozitë të cilën ankuesja e ka fituar, ndërkaq punën pritet të fillojë pas datës 16.09.2024.

5.3 Ankuesja po ashtu pretendon pa specifikuar emra, se janë propozuar kandidatë të cilët janë pensionuar dhe nuk është e punësuar në QKUK, dhe kandidatë të cilët kanë notën më të ulët se 8, po ashtu pa specifikuar me emra.

5.4 Ankuesja po ashtu pretendon se dy prej kandidatëve të propozuar janë në lidhje bashkëshortore (por nuk specifikon emra), që është në kundërshtim me statutin dhe rregulloren në fuqi

Nga sa u tha më lart, **komisioni për ankesa pas analizimit të dosjes së kandidatëve për pozitën 25, për pretendimet e ankueses, e gjen se ankesa është e bazuar në disa pika, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lënda të kthehet në Komisionin recensues për rishqyrtim.**

6. Arben Vishaj-pozita 25, ka parashtruar ankesë:

6.1 Kandidati pretendon se Komisioni recensues e ka sanksionuar me mos propozim me arsyetimin për vërejtje nga katedra Infektive nga vitet e kaluara për mos mbajtje të ushtrimeve, deklaram të ushtrimeve fiktive apo edhe vërejtje nga studentet. Ankuesi i hudhe poshte gjitha keto akuza.

Komisioni për ankesa nuk ka hasur në ndonjë dokument për akuzat e apostrofuara, dhe po ashtu është kërkuar edhe në menyrë zyrtare nga menaxhmenti i FM-së se a posedojnë ndonjë vërejtje të deponuar me shkrim për kandidatin në fjalë. Nga të njejtin kemi marrë përgjigje se nuk posedojnë një të tillë. Prandaj komisioni **propozon që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lënda të kthehet në Komision recensuese për rishqyrtim.**

7. Dukagjin Zeqiraj-pozita 25, ka parashtruar ankesë:

7.1 Kandidati pretendon se i është bërë e padrejtë pasi që nuk është respektuar rregullorja nr. Prot 2/254 e datës 17.07.2024, ku komisioni vlerësues propozon kandidatë me notë mesatare nën 8, si dhe kandidatë të pensionuar me moshë mbi 65 vjeçë.

Komisioni konstaton se ankesa është e bazuar, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lënda të kthehet në Komisionin recensues për rishqyrtim

8. Bleron Faiku-pozita 30, ka parashtruar ankesë:

8.1 Kandidati pretendon se propozimi i kandidatës Luljeta Kavaja e cila ka notën mesatare 7.36 është bërë në kundërshtim me nenin 7, pika 3.2 të rregullores 2/254 të datës 17.07.2024, sipas së ciles kandidatet e përzgjedhur duhet të kenë notë mesatare jo më të vogël se 8. Kurse ankuesi ka notën mesatare 9.27.

Komisioni konstaton se ankesa në këtë pikë **është pjesërisht e bazuar** sa i përket notes, mirepo konstaton se kandidati nuk është specialist i fushës dhe nuk ka të regjistruar specializimin dhe si rrjedhojë nuk mundë të jap mësim. Prandaj komisioni konstaton se ankesa në këtë pikë **është e pabazuar.**

8.2 Ankuesi pretendon se kandidatja tjetër e propozuar Ulpiana Rexha-Bejqi e cila ka notën mesatare 8.44, dhe nuk ka të regjistruara studimet PhD. Komisioni i ankesave

konstaton se kandidatja e propozuar Ulpiana Rexha-Bejiqi, ka noten mesatare mbi 8, është me specializim përkatës, dhe ka përvojën e punës në institucionet e arsimit të lartë (IAL), me qka ankuesi nuk i ka. Komisioni konstaton se ankesa në këtë pikë **është e pabazuar**

Nga sa u tha me lartë, **komisioni për ankesa konstaton se ankesa e kandidatit në pikën e parë është pjesërisht e bazuar, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe të merret një vendim meritore.**

9. Ulpiana Ahmeti, pozita 30, ka parashtruar ankesë:

9.1 Kandidatja pretendon se i është bërë e padrejtë me mospropozimin e sajë me arsyetimin se për pozitën të cilën ka aplikuar nuk kërkohet specializim për lëndet gjegjëse. Komisioni për ankesa konstaton se ankuesja është specisliste e Ortodoncisë, ashtu siç edhe komisioni e ka cekur si specializim joadekuat për lëndet në pikën 30. Komisioni e gjen të **pabazuar ankesën në këtë pikë.**

10. Suela Hoxha, pozita 28,30,31, ka parashtruar ankesë:

10.1 Kandidatja pretendon se në pozitën e shpallura në konkursin e Fakultetit të Mjekësisë janë përzgjedhur kandidatët në kundërshtim me Rregulloren Nr. 2/254, neni 7 pika 3.2. ku thuhet se kandidati që propozohet duhet të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dyja nivelet e studimit.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit gjen se në pozitën 28 kandidatja Lendita Perjuci Vokshi ka notën mesatare 7.78 ndërkaq ka specializim, përvojë pune si specialiste dhe është e punësuar në QKSUK. Poashtu, në pozitën 30 komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit gjen se kandidatja Luljeta Kavaja ka notë mesatare 7.36, ka specializim, ka përvojë pune në IAL dhe është e punësuar në QKSUK. Ndërsa në pozitën 31 kandidatja Tefta Bislimi ka notë 7.38, ka specializim dhe përvojë pune në IAL.

Komisioni i ankesave gjen se ankesa është e bazuar sa i përket notës mesatare, ndërkaq ankuesja nuk ka specializim dhe as të regjistruar specializimin ndërsa ka të regjistruara studimet PhD.

10.2 Kandidatja pretendon se disa nga kandidatët e përzgjedhur në pozitën 28,30,31,

mosha e tyre bie ndesh me rregulloren në fuqi.

Komisioni konstaton se kandidatet e propozuar kanë moshën që bie ndesh me rregulloren, mirepo tek lëndet klinike kandidatet duhet të jenë specialistë të fushës përkatëse apo të jenë në vitin e tretë të specializimit, si dhe duhet të jenë të punësuar në klinikën të cilën aplikojnë (sipas ligjit të shëndetësisë).

Komisioni vlerëson se për këtë rast të diskutohet në Këshillin e FM-së për një vendim meritor.

11. Miradije Imeri-pozita 35/36/37/38, ka parashtruar ankesë:

11.1 Kandidatja pretendon se komisioni recensues ka publikuar detaje të mangëta në raport recensues për kandidatet e propozuar për zgjedhje. Po ashtu kandidatja pretendon se ka përvojën e mjaftueshme të punës në mësimdhënje më të gjatë në krahasim me kandidatet e propozuara si: Diana Beqa, Kaltrina Hoti, Natyra Berisha.

Për më shumë, kandidatja pretendon se krahasuar me kandidaten Dijana Beqa, të cilës nuk i është specifikuar drejtimi i studimeve BSc dhe MA që sipas nenit 178 pika 1.1 ceket se duhet të ketë master në drejtimin përkatës. Ankuesja gjithashtu pretendon se Dijana Beqa nuk është e punësuar në QKUK, dhe ka moshën 41 vjeçare, kriter për të cilin kandidatja pretendon se komisioni recensues e ka eliminuar.

Komisioni për ankesa pas shqyrtimit të ankesës së kandidatës Miradije Imeri kundrejt Dijana Beqa e gjen se në dosjen e aplikimit online gjendet vetëm një diplomë e masterit. Andaj komisioni konstaton se ankesa drejtuar kundër kandidatës Diana Beqa është e bazuar. **Komisioni propozon që lënda të diskutohet në këshillin e FM-së, dhe të kthehet komisionit recensues për rivlerësim.**

12. Marigonë Shabani-pozita 38, ka parashtruar ankesë:

12.1 Kandidatja pretendon se komisioni recensues ka propozuar kandidaten Tringë Bekteshi për angazhim e cila është me titull BSc i Mamisë.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit gjen se kandidatja Tringë Bekteshi ka titullin BSc i Infermierise, por komisioni recensues ka bërë lëshim teknik në recenzionin e publikuar. Andaj ankesa në këtë **pikë është e pabazuar**

Kandidatja pretendon se ka përvojë pune në IAL, dhe se komisioni recensues nuk e ka

vleresuar pervojen e punës në IAL.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit gjen se e njejta ka deshmi për pervojne e punës në IAL, andaj ankesa në këtë **pikë është e bazuar.**

Komisioni konstaton se ankesa është pjesërisht e bazuar, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së

13. Abdullah Gruda, pozita 36,37 ka parashtruar ankesë:

13.1 Kandidati pretendon se me rastin e propozimit të kandidatëve për pozitat 36 dhe 37, komisioni ka perzgjedhur kandidatë që tejkalojnë moshën.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit gjen se i njejti ka moshen më të vjeter se sa kandidatet e pranuar. Andaj komisioni konstaton se **ankesa është e pabazuar.**

14. Zana Shabani-Isenaj- pozita 40/41/42/44

14.1 Kandidatja pretendon se ishte e bërë e padrejtë në vlerësimin nga komisioni vleresues se është mbi 35 vjeçë, dhe se nuk ka pervojë pune në mësimdhënje në arsimin e lartë.

Komisioni pas analizimit të dokumentacionit konstaton se ankesa e ankueses **është e bazuar.**

Mosha e kandidates është në përputhje me Statutin e UP-së, si dhe e njejta ka notë mesatare më të lartë se kandidatet e popozuar, si dhe gjejmë se e njejta ka deshmi për pervojne në mësimdhënje në IAL.

Nga sa u tha me lart, **komisioni për ankesa pas analizimit te dosjes se kandidatëve për poziten 40,41,42,44, për pretendimet e ankueses e gjen se ankesa është e bazuar andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lëndet të kthehen në Komisionet recensuese për rishqyrtim.**

15. Flora Qafleshi, pozita 43, ka parashtruar ankesë :

15.1 Ankuesja pretendon si i eshte bere e padrejte pasi qe si kriter mos zgjedhjes i eshte marre mosha mbi 35 vjeç, nderkaq deklaroi se i ka 35 vjet. Komisioni i ankesave ne baze te analizimit te dokumentacionit te ankueses, konstaton se ankuesja i ka 35 vjet, e ka

pervoje e punës në IAL si dhe është specialiste e fushës.


Komisioni konstaton se ankesa është e bazuar, andaj propozojmë që të shqyrtohet në Këshillin e FM-së dhe lënda të kthehet në Komisionin recensues për rishqyrtim

Komisioni për shqyrtimin e ankesave:

Prof. Ass. Dr. Astrit Hamza – kryetar

Prof. Ass. Dr. Aida Loshaj – anëtare

Ass. Dr. Nora Aliu - anëtare



The image shows three handwritten signatures, each written over a horizontal line. The first signature is 'Astrit Hamza', the second is 'Aida Loshaj', and the third is 'Nora Aliu'. The signatures are written in black ink.